

**KOALICIONI PËR KOMRA**

## **STATUTI**

**I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE MBI  
KRIMET E LUFTËS DHE SHKELJEVE TË TJERA TË RËNDA TË TË  
DREJTAVE TË NJERIUT NË TERRITORIN E JUGOSLLAVISË SË  
DIKURSHME**

**DRAFT**

**09 mars 2011**

# Përbajtja

## *Preambula*

### **PJESA I. – DOMETHËNIA E NOCIONEVE NË KËTË STATUT**

Neni 1. - Kuptimi i shprehjeve (nocioneve) në këtë Statut

### **PJESA II. – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 2. - Definicioni

Neni 3. - Simbolet

Neni 4. – Selia dhe Sekretariati Ekzekutiv

Neni 5. – Statusi juridik

Neni 6. – Periudha e veprimit

Neni 7. – Përfaqësimi dhe prezantimi (paraqitja)

Neni 8. – Përdorimi i gjuhëve

Neni 9. – E drejta për pjesëmarrje në punën e Komisionit

Neni 10. – Parimet e veprimtarisë së Komisionit

### **PJESA III. – Obligimi për bashkëpunim me Komisionin**

Neni 11. – Obligimi i palëve kontraktuese për bashkëpunim me Komisionin

Neni 12. – Bashkëpunimi i Komisionit me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare

### **PJESA IV. – Qëllimet dhe detyrat e Komisionit**

Neni 13. - Qëllimet

Neni 14. - Detyrat

### **PJESA V. – Kompetencat e Komisionit**

Neni 15. - Periudha dhe territori i hulumtimit

Neni 16. – Shkelja e të drejtave në kompetencën e Komisionit

### **PJESA VI. – Kompetencat e Komisionit**

Neni 17. – Marrja e deklaratave

Neni 18. – Grumbullimi i dokumentacionit dhe burimeve tjera

Neni 19. – Hulumtimet dhe vizitat në terren

Neni 20. – Dëgjimet publike të viktimateve dhe personave të tjera

Neni 21. – Mbajtja e sesioneve tematike

Neni 22. – Rregulloret e Komisionit

### **PJESA VII. – Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit**

- Neni 23.– Përbërja e Komisionit  
Neni 24.– Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit  
Neni 25. – Njëjtësia e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit  
Neni 26. – Kandidimi i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit  
Neni 27. – Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit seleksionues  
Neni 28. – Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision nga ana e Panelit zgjedhor  
Neni 29. - Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë së palëve kontraktuese  
Neni 30. – Mbledhja konstitutive  
Neni 31. – Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores  
Neni 32. – Kuorumi dhe vendimmarrja  
Neni 33. – Pushimi i mandatit të anëtarit/anëtares së Komisionit  
Neni 34. – Largimi i përkohshëm nga detyra e anëtarit/anëtares të Komisionit

#### **PJESA VIII. – Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve/anëtareve dhe personelit të Komisionit**

- Neni 35. – Ndërgjegjja, pavarësia dhe paanshmëria  
Neni 36. – Priviligjet dhe imuniteti  
Neni 37. – Mbrojtja e burimeve të të dhënave konfidenciale  
Neni 38. - Statusi i anëtarëve/anëtareve dhe personelit të Komisionit

#### **PJESA IX. – Struktura e Komisionit**

- Neni 39. – Sekretariati ekzekutiv dhe departamentet tematike  
Neni 40. – Zyrat e Komisionit në palët kontraktuese  
Neni 41. – Arkivi

#### **PJESA X. – Financimi i Komisionit**

- Neni 42. – Financimi  
Neni 43. – Raportimi financiar

#### **PJESA XI. – Raporti përfundimtar i Komisionit**

- Neni 44. – Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtarë  
Neni 45. – Përmbytja e Raportit përfundimtarë  
Neni 46. – Gjetjet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtës njerëzore  
Neni 47. – Obligimet e parlamenteve dhe qeverive për shqyrtimin e Raportit përfundimtarë

#### **PJESA XII. – Të ndryshme**

- Neni 48. – Dispozitat ndëshkuese (Dënimet)  
Neni 49. – Roli i Komisionit në procedimin penal

#### **PJESA XIII. – Dispozitat përfundimtare**

- Neni 50. – Përfundimi i punës së Komisionit  
Neni 51. – Hyrja në fuqi e Statutit

## *Preambula*

### ***Palët kontraktuese,***

Duke vërejtur se gjykimet para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë dhe në gjykatat vendore, edhe pse kontribuojnë në dënimin e kryerësve të krimit, nuk i përm bushin, në masë të duhur, nevojën e viktimave për drejtësi, dhe as vetveti nuk mund të krijojnë kushte të mjaftueshme për arritjen e qetësisë së qëndrueshme në rajon;

Duke shprehur bashkëndjesi me viktimat e të gjithë popujve në territorin e RSFJ-së së dikurshme, dhe duke kundërshtuar keqpërdorimin e viktimave për qëllime politike dhe konkurrencë të viktimizimit;

Duke vërejtur se iniciativa e ndërmarrë në nivel rajonal, dhe e bazuar në dialog të hapur, hulumtim dhe analizë, fakte, paraqet rrugën më të mirë të të dhënavë gjithëpërfshirëse historike mbi krimet të cilat janë kryer në periudhën e përmendur, si dhe për rolin e elitave nacionale, institucioneve dhe individëve në ngjarjet traumatike;

Të vendosura që në masën më të madhe të mundshme të ndihmojnë për vërtetimin e fatit të një numri të madh të individëve të cilët edhe më tutje evidentohen si të humbur (të pagjetur);

Të vendosura që bashkërisht të kontribuojnë në pranimin e provave (fakteve) mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut ndaj të gjitha viktimave dhe përtëritjes së mirëbesimit në mes të individëve, popujve dhe shteteve në rajon;

Me qëllim të forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të kulturës për respektimin e të drejtave të njeriut,

### ***Shpallin***

***Themelin e Komisionit rajonal për vërtetimin e provave (fakteve) mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e ish RSFJ-së, në periudhën nga viti 1991 deri në vitin 2001.***

# PJESA I. – KUPTIMI I SHPREHJEVE NË KËTË STATUT

## Neni 1.

### *Kuptimi i shprehjeve (nocioneve) në këtë Statut*

- “Luftëtarët” në kontekstin e konfliktit të armatosur ndërshtetërore janë :
  - Pjesëtarë të forcave të armatosura të njërsës anë në konflikt, si dhe pjesëtarë të policies dhe njësive vullnetare të cilat hyjnë në përbërje të këtyre forcave të armatosura,
  - Pjesëtarët e policiesë dhe të njësive të tjera vullnetare, duke përfshirë edhe lëvizjet e organizuara të rezistencës, që i përkasin njërsës anë të konfliktit dhe të cilat veprojnë jashtë apo brenda territorit të tyre, edhe në qoftë se ky territor është i pushtuar, me kusht që këto polici apo njësi vullnetare, duke përfshirë këtu dhe lëvizjet e organizuara të rezistencës i plotësojnë kushtet si në vijim:
    - a) që në krye të kanë një person vartës të përgjegjësisë;
    - b) të kenë një shenjë të caktuar dalluese e cila mund të shihet në distancë;
    - c) që haptazi të mbajnë armë;
    - d) që në kryerjen e operacionit të tyre i përmbahen ligjeve apo zakoneve të luftës;
  - Pjesëtarë të forcave të rregullta të armatosura të cilat rrëfejnë që i takojnë ndonjë qeverie apo shteti të cilën nuk e ka njojur fuqia ndër autoritetin e të cilit janë;
  - Popullata e territorit të pa pushtuar e cila gjatë afrit të armikut, në mënyrë të vullnetshme marrin armët për t'i rezistuar pushtimit armiqësor, dhe e cila nuk ka pasur kohë për tu organizuar si një forcë e rregullt e armatosur, edhe nëse i respektojnë ligjet dhe zakonet (dmth. Levee en masse).

*Luftëtarë* në konfliktet e armatosura jo-ndërshtetërore konsiderohen:

- pjesëtarët e forcave të armatosura të shtetit, dhe
- pjesëtarët e forcave të armatosura disidente dhe grupeve të armatosura tjera të organizuara, të cilat nën komandën përgjegjëse, kryejnë kontrollin mbi një pjesë të caktuar të territorit që ju mundëson të zbatojnë operacione të vazhdueshme dhe të përbashkëta ushtarake, dhe të zbatojnë dispozitat e të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të përcaktuara me Protokollin Plotësues II nën katër Konventat e Gjenevës.
- “Civil” janë të gjithë personat që nuk janë luftëtarë.
- “Anëtar/anëtarja e Komisionit”, është person i zgjedhur nga ana e kryetarit të palës kontraktuese, sipas procedurës të paraparë në Pjesën VII. të Statutit;

- ***"Komisioni"*** është Komision Rajonal për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (shkurtesa e emrit është: KOMRA)
- ***„Vendi i paraburgimit”*** është një hapësirë e mbyllur ose e hapur në të cilin gjenden një apo më shumë persona të cilët janë të privuar nga liria;
- ***“Ministri kompetent për të drejtat e njeriut”***, nënkuption ministrin/ministren për të drejtat e njeriut dhe të pakicave në shtetet ku ekziston një pozitë e tillë, ndërsa në shtetet tjera ministri/ministrja e drejtësisë, gjegjësish ministri/ministrja për komunitetet dhe kthim;
- ***„Personi i zhdukur”*** është personi i arrestuar, në paraburgim, i rrëmbyer apo në çfarëdo mënyre tjetër i privuar nga liria nga ana e autoriteteve shtetërore apo grupit të armatosur e cila aktivisht kundërvihet, gjegjësish nga ana e një personi apo grupei njerëzish të cilët veprojnë sipas urdhrit, me mbështetje dhe pëlqim të organeve shtetërore apo të grupit të armatosur, pas së cilës organi (autoriteti) apo personi, gjegjësish grupet, të cilat e kanë privuar nga liria personin, ato refuzojnë të pranojnë se kanë privuar nga liria, apo nuk tregojnë përfatim e personit të zhdukur ose vendin ku gjendet ai.
- ***„Pjesëtarë të forcave të armatosura”*** janë pjesëtarë të forcave të armatosura të rregullta të një shteti, pra grupe dhe njësi të vëna nën komandën që i përgjijet shtetit.
- ***“Lufta ose forma tjetër e konfliktit të armatosur”***, nënkuption përdorimin e forcës së armatosur ndërmjet shteteve ose dhunës së vazhdueshme të armatosur ndërmjet pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, gjegjësish ndërmjet grupeve të armatosura të organizuara brenda një shteti;
- ***“Krim lufte”***, nënkuption domethënien e terminit *“krim lufte”* në të drejtën penale ndërkombëtare, gjenocid dhe krime kundër njerëzimit, dhe përfshinë por nuk kufizohet në krimet e kryera si në vijim:
  - a. gjenocid;
  - b. persekutim;
  - c. vrasje;
  - d. robërim;
  - e. arrestim i paligjshëm;
  - f. torturë;
  - g. zhdukjet e dhunshme;
  - h. dëbim dhe zhvendosje e dhunshme e popullatës;

- i. përdhunimi dhe format e tjera të rënda të abuzimit seksual;
  - j. konfiskimi dhe shkatërrimi i pronave në përmasa të mëdha;
  - k. marrja e pengjeve;
  - l. shkatërrimi i objekteve fetare, kulturore, historike;
  - m. përdorimi i civilëve dhe të burgosurve të luftës si mburojë njerëzorë (e gjallë).
- ***“Trupi parlamentar kompetent për të drejtat e njeriut dhe të pakicave”***, nënkupton, varësisht nga emri në palët e ndryshme kontraktuese, këshilllet parlamentare ose komisionet kompetente për të drejtat e njeriut ose marrëdhënie ndërnacionale;
- ***“Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ)”***, është shteti që e përbënin gjashtë republika socialiste, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Slovения, Serbia dhe dy krahina autonome; Kosova dhe Vojvodina; dhe e cila *de facto* ka ekzistuar që nga 29.11.1943, deri në shkatërrimin e saj në vitin 1991, në ndërkokë duke ndërruar emërtimin disa herë;
- ***“Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut”***, përfshijnë: vrasjet, robërimet, burgosjen e padrejtë, torturimin, zhdukjet e dhunshme, deportimin dhe shpërnguljen e dhunshme të popullsisë, diskriminimin sistematik, si dhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut, të parapara me Konventat Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat i kanë obliguar të gjitha palët kontraktuese (nënshkruese), për të cilat Komisioni vlerëson se sipas karakteristikave dhe pasojave të tyre kanë karakter të “shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut”;
- ***“Kryerësi”***, është personi i cili është dënuar ligjërisht si kryes (autor) i krimit, bashkëpunëtorë apo pjesëmarrës në kryerjen e krimit të luftës apo veprave tjera që paraqesin shkelje tjera të të drejtave të njeriut;
- ***“Viktimat”*** janë personat të cilët, individualisht ose në mënyrë kolektive, kanë pësuar dëme, duke përfshirë shkeljet fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose kufizime të konsiderueshme e të drejtave të tyre themelore përmes veprimeve ose mosveprimeve që paraqesin shkeljen e rëndë e të drejtave njerëzore të pranuara me të drejtën ndërkombëtare, ose shkelje të rëndë e të drejtës humanitare ndërkombëtare. Termi viktima, gjithashtu përfshinë edhe anëtarët e familjes së ngushtë ose personat të cilët viktima ka qenë ushqyes i tyre i drejtpërdrejtë, si dhe personat të cilët kanë pësuar gjatë ndërhyrjes, qëllimi i të cilës ka qenë për ti ndihmuar viktimës apo të parandalojë shkeljet tjera;

## PJESA II. – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 2.

#### *Definicioni*

1. Komisioni rajonal për vërtetimin e provave (fakteve), mbi krimet e luftë dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish RSFJ-së, është Organizatë Ndërkombëtare e themeluar me këtë akt ligjor.
2. Shkurtesa është KOMRA.

### Neni 3.

#### *Simbolet*

Komisioni vendos mbi identitetin e vet vizual që përfshinë emblemën, logon dhe vulën.

### Neni 4.

#### *Selia dhe Sekretariati Ekzekutiv*

1. Selia e Komisionit është në Sarajevë.
2. Mbështetje në punën e anëtarëve dhe anëtarave të Komisionit siguron Sekretariati Ekzekutiv, në selinë e Komisionit.

### Neni 5

#### *Statusi juridik (ligjor)*

1. Komisioni ka subjektivitet ligjor.
2. Komisioni miraton rregulloren dhe rregulloret me të cilat rregullohet organizimi dhe implementimi i detyrave të tija, në pajtim me këtë Statut.
3. Komisioni, me pushtetin kompetent të Bosnjës dhe Hercegovinës, do të lidhë Marrëveshje mbi aranzhmanet me vendin nikoqir.

### Neni 6

#### *Periudha e veprimit*

1. Periudha e veprimit të Komisionit është tri vjet.
2. Periudha e veprimit të Komisionit nuk përfshinë periudhën e përgatitjeve, e cila fillon nga mbledhja konstitutive dhe vazhdon, më së gjati gjashtë muaj.

**3. Komisioni mund ta vazhdojë (zgjasë) periudhën e veprimit më së shumti për gjashtë muaj.**

#### **Neni 7.**

##### *Përfaqësimi dhe paraqitja*

- 1. Komisionin e përfaqëson dhe paraqet kryesuesi/ja i/e Komisionit.**
- 2. Komisioni mund të vendos që ta përfaqësojë një anëtarë/re tjetër.**

#### **Neni 8**

##### *Përdorimi i gjuhëve*

- 1. Në punën e Komisionit, në përdorim të barabartë janë gjuha shqipe, boshnjake, malazeze, kroate, maqedonase, sllovene dhe serbe, si dhe alfabeti cirilik dhe latin.**
- 2. Komisioni, në mënyrë të detajuar me Rregullore, do të rregullojë përdorimin e gjuhës dhe alfabeteve, duke respektuar parimet e efikasitetit dhe nikoqirillëkut.**
- 3. Në komunikim me Komisionin, secili ka të drejtë të shfrytëzojë gjuhën dhe alfabetin e vet.**
- 4. Në dëgjimet publike, pjesëmarrësit flasin në gjuhën e tyre,**
- 5. Në zyret e palëve kontraktuese, në pikëpamje të gjuhës zbatohen dispozitat e shtetit në të cilin gjendet zyra.**

#### **Neni 9.**

##### *E drejta për të kontribuar në punën e Komisionit*

Secili gjëzon të drejtën, në përputhje me Statutin, të marrë kontribuojë në punën e Komisionit, nëse Komisioni vlerëson se nëse një gjë e tillë do të kontribuojë në realizimin e qëllimeve të tij.

#### **Neni 10.**

##### *Parimet e veprimit të Komisionit*

Anëtarët/anëtaret si dhe personeli i Komisionit janë të obliguar që në punën e tyre të udhëhiqen me këto vlera dhe parime:

- (a) respektimi i dinjitetit njerëzor,**
- (b) pavarësia dhe paanshmëria,**
- (c) përkushtimi për të vërtetën,**
- (d) barazia dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut,**
- (e) përgjegjësia, qasja dhe të qenit të hapur,**
- (f) hulumtimi me kujdes i fakteve (provave) dhe procedura e drejtë,**
- (g) integritet, vendosmëri dhe përbajtje në standarde më të larta profesionale dhe etike,**
- (h) mbrojtja e veçantë e viktimave të keqtrajtimit seksual si dhe personave të cilët ishin të mirur në periudhën të cilën e përfshinë mandati i Komisionit,**

(i) konfidencialiteti.

## PJESA E III – OBLIGIMI I BASHKËPUNIMIT ME KOMISIONIN

**Neni 11.**

### *Obligimi i bashkëpunimit të palëve kontraktuese me Komisionin*

1. Palët kontraktuese, janë të obliguara të bashkëpunojnë me Komisionin, dhe të njëjtit ti mundësojnë kryerjen e detyrave në përputhje me Statutin.
2. Organet kompetente të pushtetit në palën kontraktuese, në kërkesë të Komisionit, me kohë do të sigurojnë qasje në të dhëna, në dokumente, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe zbatimin e hulumtimeve në teren, përpos nëse me të nuk do të shkelen rregullativat e palës kontraktuese për konfidencialitetin e të dhënave.
3. Të dhënat ose dokumentet, që tregojnë për kryerje të kimeve të luftës apo për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, dhe apo në kryesit e mundshëm, si dhe dokumentet të cilat janë hartuar me qëllim të fshehjes të kimeve të kryera apo të shkeljeve étë të drejtave të njeriut, që nuk vlerësohen konfidentiale.
4. Në rastin kur shteti konsideron që zbulimi i të dhënave të caktuara ose dokumenteve të cilat i ka kërkuar Komisioni, do të ishte në kundërshtim me rregullativat për konfidencialitet, do të ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të tejkalimit të situatës kontestuese, me angazhim të përbashkët të Komisionit dhe Shtetit. Këto masa nënkuqtojnë, por nuk kufizohen vetëm në:
  - (a) Deklarimin e Komisionit lidhur me atë se sa janë relevante të dhënat dhe dokumentet të cilat i kërkon;
  - (b) Sqarimin ose ndryshimin e kërkesës,
  - (c) Shqyrtimin e mundësive të marrjes së të dhënave ose dokumenteve nga një burim tjetër ose në një mënyrë tjetër;
  - (d) Marrëveshjen mbi kushtet e zbulimit të të dhënave, duke përfshirë, ndër të tjera, zbulimin e pjesëm e përbajtjes së dokumenteve, kufizimin në publikimin e të dhënave si dhe zbatimin e masave tjera mbrojtëse mbi konfidencialitetin e të dhënave.

**Neni 12**

### *Bashkëpunimi i Komisionit me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare*

Komisioni mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me shtetet jashtë territorit të RSFJ-së së dikurshme dhe me organizatat ndërkombëtare.

## PJESA E IV. – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISONIT

### Neni 13.

#### *Qëllimet*

Komisioni ka këto qëllime:

- Të vërtetojë provat (faktet) për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat në ish RSFJ-së, në periudhën nga 1 Janari i vitit 1991 deri më 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat shoqërore dhe politike të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre kimeve dhe shkeljeve të të drejtave;
- Të pranojë padrejtësitë e shkaktuara ndaj viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkëndjenjës për viktimat
- Të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave
- Të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në palët kontraktuese të pranojnë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.;
- Të kontribuojë në ndriçimin e fatit të humburve – pagjeturve... dhe
- Të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së kimeve dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

### Neni 14.

#### *Detyrat*

Komisioni ka këto detyra:

- Të grumbulloj të dhëna për rastet e kimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut dhe kimeve të luftës, të ofrojë përshkrim të detajuar për to, dhe të pasqyrojë përmes formularëve shkeljet e të drejtave dhe pasojat e tyre;
- Të grumbullojë të dhëna për fatin e të humburve dhe të bashkëpunojë me trupat kompetente të cilat, në palët kontraktuese, merren me hulumtimin për të zhdukurit;
- Të bëjë inventarizimin e humbjeve në njerëz për:
  - civilët të cilët kanë humbur jetën ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;
  - luftëtarët të cilët kanë humbur jetën, ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;
- Të grumbulloj të dhëna mbi vendet e burgosjes të ndërlidhura me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur, të personave ét cilët janë burgosur në mënyrë joligjore, u janë nënshtuar torturave dhe sjelljeve jonjerëzore, dhe të hartojë një regjistrim gjithëpërfshirës, me mbrojtjen e identitetit të tyre në rastet kur është e nevojshme;
- Të hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat në mënyrë vendimtare kanë ndikuar në shpërthimin e luftërave pse formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e kimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut
- Që të mbajë dëgjime publike, të viktimave dhe personave tjerë, për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut,

- g. Të rekomandojë masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe reparacionin për viktimat;
- h. Të hartoj, publikojë dhe prezantojë reportin përfundimtarë, në mënyrën që ai të mund të depërtojë deri të një numër sa më i madh i njerëzve në shtetet e territorit të ish RSFJ-së.

## PJESA E V. – KOMPETENCA E KOMISIONIT

Neni 15.

### *Kompetencat kohore dhe territoriale*

Komisioni vërteton faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në periudhën nga data 1 Janar 1991 deri me 31 dhjetor 2001, në shtetet në hapësirat e ish RSFJ-së, dhe hulumton rrëthanat politike dhe shoqërore, të cilat bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e luftërave ose i formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe faktin e kryerjes së kimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda e të të drejtave të njeriut, si dhe pasojat e kimeve dhe të shkeljeve të drejtave të njeriut, të cilat janë shfaqë në periudhën pas viti 2001.

Neni 16.

### *Shkeljet e ligjit në kompetencën e Komisionit*

Komisioni vërteton faktet lidhur me krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të cekura në nenin 1, të Statutit.

## PJESA VI. – AUTORIZIMET E KOMISIONIT

Neni 17.

### *Marrja e deklaratave*

1. Komisioni merr deklaratat mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, sipas kompetencës së vet, nga viktimat, dëshmitarët, përfaqësuesit e institucioneve, dhe kryesit e veprave.
2. Komisioni tenton të sigurojë dhënien vullnetare të deklaratës, duke ruajtur kompetencës e saj sipas paragrafit 8, të këtij neni. Viktimat i japin deklaratat për vuajtjet e tyre dhe të afërmve të tyre, vetëm në bazë vullnetare.
3. Viktimat japin deklaratat për vuajtjet e tyre dhe të familjarëve të tyre, vetëm në bazë vullnetare.
4. Në rast se personi refuzon për ti dhënë deklaratë Komisionit, duke u thirr në detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit të dhënave, zbatohen dispozitat e nenit 11, paragrafit 3 dhe 4 të këtij Statuti.

5. Dispozitat e ligjit për procedurën penale në palën kontraktuese zbatohen në të drejtën e shkurtimit të dhënes së përgjigjes në çështjet e caktuara dhe lirimt nga detyrimi për të dëshmuar, si dhe çështje të tjera lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve, të cilat nuk janë të rregulluara me Statut ose me rregulloren e Komisionit.
6. Në bazë të kërkesës së dhënësit të deklaratës, Komisioni mund të mundësojë edhe dhënen e deklaratës në mbrojtje të identitetit.
7. Komisioni bën thirrje për personat, e përmendur në paragrin 1, në mënyrën e përcaktuar me rregullat për thirrjen e dëshmitarëve, sipas procedurës penale të palëve kontraktuese. Komisioni mund të lidhë marrëveshje të veçantë me palët kontraktuese për mënyrën e thirrjes.
8. Nëse e vlerëson të përshtatshme (dobishme), Komisioni mund t'ia paraqesë kërkesën gjykatës së qarkut kompetente për sigurimin e pjesëmarrjes së personit të caktuar, gjegjësisht lidhur me shqiptimin e dënimit personit i cili refuzon të përgjigjet në thirrjen për dhënie të deklaratës, në pajtim me ligjin për vepër penale të shtetit në të cilin ai person e ka vendbanimin, apo vendqëndrimin
9. Para, gjatë dhe pas dhënes së deklaratës, Komisioni sipas nevojës, siguroj ndihmën psiko-sociale për viktimat dhe dëshmitarët.
10. Komisioni i merr deklaratat:
  - a. në vendbanimin apo në vendqëndrimin e dhënësit te deklaratës,
  - b. në zyrat e Komisionit,
  - c. në përfaqësitetë diplomatike-ambasadat dhe konsullatat e palëve kontraktuese, nëse kontrata merret në vendet e treta,
  - d. në territorin e shteteve të treta, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të atyre shteteve, dhe në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund të jepin deklarata në konsullatat dhe ambasadat e palëve kontraktuese.

#### Neni 18.

##### *Grumbullimi i dokumentacioneve dhe burimeve tjera*

1. Komisioni grumbullon materiale burimore relevante të shkruara dhe elektronike, siç janë:
  - a. burimet e huaja dhe vendore të shkruara dhe elektronike (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në dokumentacionin e Qeverise, Kuvendit, Presidencës, vetëqeverisjeve lokale dhe territoriale, ndërmarrjeve publike dhe private, ushtrisë, policisë, shërbimeve informative dhe të sigurisë),
  - b. aktgjykimet gjyqësore, transkriptet, shkresat gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë, gjykatave nationale në palët kontraktuese dhe gjykatave tjera të cilat zhvillojnë procedura për krime lufte të kryera në territorin e ish Jugosllavisë në bazë të kompetencave universale;
  - c. lëndët arkivore;
  - d. burimet mediale të shkruara dhe elektronike;
  - e. mendimet e shkruara të ekspertëve dhe përfaqësuesë të institucioneve, dhe organizatave të përgatitura me ftesë të Komisionit ose me veticinitativë të autorëve.
2. Organet shtetërore, personat e tjerë juridik dhe qytetarët e palëve kontraktuese, janë të obliguar që në kërkesë të Komisionit me kohë ti dorëzojnë në shqyrtim të gjitha

- dokumentet dhe burimet tjera, të cilat do të mund të ishin të rëndësishme për realizimin e qëllimit të saj.
3. Me rastin e dorëzimit të ftesës për dorëzimin e dokumentacionit, Komisioni tenton që sa më saktë të precizojë llojin e informatës, të cilën do të duhej ta përmbajë dokumenti i kërkuar.
  4. Në rast se personi ose organi shtetërorë refuzon të dërgojë dokumentacionin Komisionit, duke u thirrur në detyrën ligjore për ruajtjen e konfidencialitet e të dhënavë, zbatohet dispozita e nenit 10, paragrafi 2 dhe 3, i këtij Statuti.

#### Neni 19.

##### *Hulumtimet dhe vizitat në teren*

1. Komisioni vërteton faktet (provat) relevante duke shkuar në teren, vizitës në lokalitetet e krimit, vendet e robërimit, varrezave masive dhe të gjitha lokalitet tjera me interes për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda e të drejtave të njeriut,
2. Komisioni mund të lidhë marrëveshje mirëkuptimi, me organet shtetërore kompetente, për vizitat e saj në lokacionet e lartpërmendura.
3. Komisioni mund të vizitojnë vendet e krimeve dhe varrezat masive, në mënyrë që të shprehin respekt për viktimat.

#### Neni 20 .

##### *Dëgjimi publik i viktimave dhe personave tjerë*

1. Komisioni mban dëgjime publike në të cilat viktimat flasin mbi vuajtjet e tyre dhe të afërmeve të tyre.
2. Dëgjimet publike përfshijnë edhe kryerësit e veprave të cilët kanë karakter të krimit të luftës ose të shkeljeve tjera të rënda e të drejtave të njeriut, dëshmitarët si dhe persona që iu kanë ndihmuar viktimave.
3. Dhënia e deklaratave në dëgjin publik është me vullnet,
4. Para, gjatë dhe pas dëgjimeve publike, Komisioni mund të aplikojë masa për mbrojtjen e identitetit, si dhe masa të veçanta për mbrojtje të integritetit psiko – fizik, si dhe masat e ndihmës psiko-sociale.
5. Mediet elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht Shërbimet publike, në territoret e palëve kontraktuese, kanë për detyrë të transmetojnë dëgjimet publike. Mënyra e transmetimeve bëhet sipas marrëveshjes mes Komisionit dhe transmetuesve publik. Mediet elektronike komerciale kanë të drejtë të emitojnë dëgjimet publike, nën kushte të njëjtë dhe sipas rregullave të cilat vleinë dhe për mediet në pronësi shtetërore, përkatesisht servile publike.
6. Dëgjimet publike mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

## Neni 21.

### *Mbajtja e sesioneve tematike*

1. Komisioni mund të mbaj sesione publike mbi punën e institucioneve shtetërore, organizatave politike, enteve kulturore dhe shkencore, kishave dhe bashkësive fetare, dhe medieve para ose gjatë luftës, gjegjësisht formave të tjera të konfliktit të armatosur, dhe që kanë të bëjnë me kryerjen e kimeve të luftë dhe shkeljeve tjera të rënda të drejtave të njeriut.
2. Pjesëmarrja në sesionet tematike është e obligueshme. Nëse personi i cili është ftuar në mënyrë të rregullt, pa shkak të arsyeshëm, nuk i përgjigjet thirrjes së Komisionit për pjesëmarrje në sesionin tematik, ose vjen por refuzon ét japë deklaratë, aplikohet nen 17, paragrafi 8, i Statutit.
3. Mediet elektronike në pronësi shtetërore, gjegjësisht Shërbimet publike, në hapësirat e palëve kontraktuese, kanë për obligim që të transmetojnë direkt apo në termine tjera, sesionet tematike të Komisionit. Mënyra e transmetimit të sesioneve tematike, rregullohet në bazë të marrëveshjes mes Komisionit dhe shteteve kontraktuese. Mediet elektronike komerciale kanë të drejtë të transmetojnë sesionet tematike, nën kushte të njëjtë dhe sipas rregullave që vlejnë për media në pronësi shtetërore, gjegjësisht servile publike.
4. Sesionet tematike nuk mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

## Neni 22.

### *Rregulloret e Komisionit*

Komisioni nxjerr rregulloret e veçanta me të cilat rregullohet metodologja unike për:

- marrjen e deklaratave,
- grumbullimin e dokumentacionit,
- rregullimin e procedurave për dëgjime publike,
- rregullimin e sesioneve tematike,
- hartimi i listës të humbjeve në njerëz,
- sigurimi i ndihmës psiko-sociale dhe mbështetja për viktimat, dhe
- çështje të tjera të rëndësishme për punën e Komisionit.

## **PJESA VII – ZGJEDHJA E ANTARËVE DHE ANTAREVE TË KOMISIONIT**

## Neni 23.

### *Përbërja e Komisionit*

Komisionin e përbëjnë 20 anëtarë dhe anëtare, me ç'rast:

- a. në Bosnjë dhe Hercegovinë zgjidhen 5 anëtarë/anëtare;
- b. në Republikën e Kroacisë, Republikën e Kosovës – Kosova/UNMIK, dhe Republikën e Serbisë zgjidhen nga 3 anëtarë/anëtare,

- c. në Mal të Zi, Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Slovenske, zgjidhen nga 2 anëtarë/anëtare.

#### **Neni 24.**

##### *Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit*

1. Anëtarë/anëtarja e Komisionit është:
  - a. Shtetas/shtetase e palëve kontraktuese;
  - b. Person me kualitete të larta morale, me integritet dhe autoritet, i përkushtuar dialogut tolerant dhe konstruktiv për zgjedhjen e kontesteve, i cili mund të gëzojë besimin në të gjitha palët kontraktuese, dhe
  - c. Person me aftësi psiko-fizike për kryerjen efikase dhe në kontinuitet të detyrave të anëtarit/anëtares së Komisionit.
2. Në palën kontraktuese zgjidhet së paku një femër, gjegjësisht së paku një mashkull, për anëtarë/e të Komisionit.
3. Në palën kontraktuese, me rastin e zgjedhjeve të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit do të përkushtohet që të sigurojë edhe përfaqësimin etnik në komision, në atë mënyrë që krahas pjesëtarit/pjesëtares nga radhët e Bashkësisë më të madhe në numër, do të mundohet që të zgjedhë edhe njérin/njérën ose më shumë pjesëtarë/pjesëtare nga bashkësia tjetër etnike, gjegjësisht nga bashkësítë tjera etnike në atë palë kontraktuese;
4. Anëtarë/anëtar e Komisionit nuk mund të jetë personi:
  - a. Që ka ushtruar funksion të shqar politik në dy vitet e fundit, para shpalljes së konkursit për zgjedhje të anëtarëve/anëtareve të Komisionit, ose në periudhën kohore e cila është përfshirë në kompetencën e Komisionit;
  - b. Për të cilin/cilën ekziston dyshimi i bazuar se është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, ose ka mbështetur, ndihmuar ose nxitur kryerjen e veprave të tillë, ose ka kontribuar në mos dënimin e atyre veprave, ose është në lidhje të ngushta me personin e gjykuar, akuzuar ose që është nën hetime për vepra të tillë.

#### **Neni 25.**

##### *Njëjtësimi i procedurës në përzgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit*

Në secilën palë kontraktuese, zgjidhen anëtarët/anëtaret e Komisionit në procedurë të njëjtë të paraparë me këtë Statut.

#### **Neni 26.**

##### *Kandidimi i anëtarëve dhe anëtareve*

1. Shoqatat e qytetarëve, institucionet arsimore, institucionet shkencore, bashkësítë fetare, sindikatat ose 30 qytetarë të palës kontraktuese mund të propozojnë

kandidat/kandidate pér anëtarë/anëtare të Komisionit, i cili (cila) zgjidhet në atë palë kontraktuese, me pëlqimin e kandidatit/kandidates.

2. Procedurat e kandidimit dhe seleksionimit primar të kandidatit/kandidates në palën kontraktuese i zbaton Komisioni seleksionues.

## Neni 27.

### *Përbërja dhe zgjedha e Këshillave seleksionuese*

1. Këshilli seleksionues në secilin shtet e përbëjnë 9 anëtarë/anëtare, të cilët duhet ti plotësojnë kriteret të cilat vlejnë pér përgjedhjen e anëtarëve/anëtareve të Komisionit, përveç ndalesës pér kryerjen e funksioneve të theksuara politike në periudhën në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit pér zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, dhe në periudhën e cila përfshihet në kompetencën e Komisionit.
2. Anëtarët/anëtaret e Këshillit seleksionues nuk mund të kandidohen pér anëtarësim në Komision.
3. Tre anëtarët/anëtaret e Këshillit seleksionues i emëron ministri kompetent pér të drejtat e njeriut, ose nëse një i tillë nuk ekziston në shtetin kontraktues, ministri kompetent pér drejtësi, në pëlqim të Komisionit parlamentar ose të Komisionit kompetent pér të drejtat e njeriut ose marrëdhënie ndërnacionale.
4. Tre anëtarë/anëtare të Këshillit seleksionues përzgjidhen nga anëtarët e Koalicionit pér KOMRA në palën kontraktuese.
5. Gjashtë anëtarët/anëtaret e parë të Këshillit seleksionues emërohen, gjegjësisht zgjedhën në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni në afat prej 45 ditësh, nga dita e ratifikimit të fundit të Kontratës ndërkombëtare pér themelimin e Komisionit.
6. Ministri kompetent shpallë zgjedhjen e katër anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit seleksionues, dhe në afat prej 8 ditsh shpall konkursin pér zgjedhjen edhe të 3 anëtarëve/anëtareve të komisionit.
7. Gjashtë anëtarët/anëtaret e përzgjedhur më parë, do vazhdojnë dhe të zgjedhin tre anëtarët/anëtaret e mbetur të Këshillit seleksionues, me konsensus, dhe nëse një gjë e tillë nuk do të jetë e mundur, atëherë zgjedhja bëhet me shumicë të votave.
8. Ministri kompetent, Koalicioni pér KOMRA dhe anëtarët/anëtaret e Këshillit seleksionues i emëruar dhe i zgjedhur në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, do të sigurojnë që së paku 1/3 të anëtarësisë ta përbëjnë femrat, gjegjësisht meshkujt, dhe do të përkushtohen që të sigurojnë që 1/3 të anëtarësisë ta përbëjnë përfaqësuesit/përfaqësueset e shoqatës së viktimate, duke përfshirë edhe shoqatat e viktimate të cilat nuk janë anëtare të Koalicionit pér KOMRA, me kusht të jenë të regjistruara së paku tri vjet para nënshkrimit të kontratës pér themelimin e Komisionit.
9. Ministri kompetent shpallë zgjedhjen e Këshillit seleksionues dhe i siguron kushtet pér punën e tij.
10. Me Këshillin seleksionues kryeson anëtari/anëtarja më i mosuar, i cili/a e cakton mbajtjen e seancën konstitutive në afat prej 43 ditësh nga dita e shpalljes së konkursit nga parografi 6 të këtij neni.

## Neni 28.

### *Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim për Komisionin nga ana e komisionit seleksionues*

1. Këshilli seleksionues, në secilin shtet, në afat prej 8 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes konstitutive, shpallë konkurs për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, në afat prej 30 ditësh.
2. Në afat prej 8 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit, Këshilli seleksionues shpallë në internet faqen e Ministrisë kompetente sipas nenit 27, paragrafi 3, si vijon:
  - a. Numrin e përgjithshëm të kandidaturave të arritura;
  - b. Listën e emrave të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve do të shqyrtohen,
3. Këshilli seleksionues mund të vendosë që ti intervistojë të gjithë ose disa prej kandidatëve/kandidateve. Intervista është e hapur për publik.
4. Këshilli seleksionues mund të kërkojë informata për kandidatin/kandidaten nga organet shtetërore dhe institucionet publike, ndërsa ato janë të obliguara që në kërkesë të Këshillit për qasje në informata të përgjigjen me urgjentisht.
5. Këshilli seleksionues tenton që të gjitha vendimet ti marrë me vendim unanim, ndërsa në rast kur konsensusi nuk mund të arrihet, do ët vendoset me shumicë prej 5 anëtarëve/eve.
6. Këshilli seleksionues vlerëson plotësimin e kushteve të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve i ka marrë në shqyrtim dhe e ngushton përzgjedhjen në listën e cila përmban numrin për dy deri në tre herë më të madh të kandidatëve dhe kandidateve nga nuri i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilat zgjedhën në palën kontraktuese.
7. Në afat prej 40 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit Këshilli seleksionues shpallë listën e kandidatëve/kandidateve, dhe të njëjtën ia dërgon, po të njëjtën ditë, kryetarit/kryesisë së palën kontraktuese.

## Neni 29.

### *Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë së palëve kontraktuese.*

1. Kryetari/kryesia e shtetit kontraktues kryejnë zgjedhjen përfundimtarëve të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilët zgjedhën në palën kontraktuese në mesin e kandidatëve dhe kandidateve nga lista të cilën ia dërgon Këshilli seleksionues.
2. Kryetarët/kryesitë e palëve kontraktuese do e informojnë njëri tjeterin mbi zgjedhjet e tyre 30 ditë nga dita kur Këshilli seleksionues iu dërgojnë listën e kandidatëve, para se për këtë ta informojnë publikun.
3. Kryetarët/kryesia e palëve kontraktuese shpallin emrat e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit 15 ditë nga dita kur të gjithë pranojnë njoftimin nga paragrafi 2 të këtij neni.

## Neni 30.

### *Mbledhja konstitutive*

1. Anëtarri/anëtarja më e vjetër e Komisionit thërret mbledhjen konstitutive në selinë e Komisionit, në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjeve, dhe kryeson Komisionin deri në zgjedhjen e anëtarit kryesues/anëtares kryesuese.
2. Në pjesën solemne, hyrëse, të mbledhjes konstitutive të Komisionit, të hapur për opinion, marrin pjesë kryetari/anëtarët e kryesisë së palëve kontraktuese.
3. Në pjesën hyrëse të mbledhjes konstitutive anëtarët/anëtaret e Komisionit nënshkruajnë një ekzemplarë të Statutit, dhe nënshkruajnë dhe me nënshkrim, me zë lexojnë këtë deklaratë: "beto hem me nderin tim që funksionin e anëtarit/anëtares të Komisionit do ta kryej në përpjekje me Statusin, me përkushtim, me paanshmëri dhe i pavarur, duke u përpjekur që të arsyetojë besimin e dhënë dhe të kontribuoj në realizimin e qëllimeve të Komisionit".

## Neni 31.

### *Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores*

1. Anëtarët dhe anëtaret e Komisionit zgjedhin anëtarin kryesues / anëtaren kryesuese dhe miratojnë Rregulloren e punës së Komisionit në afat prej 60 ditësh nga dita e mbledhjes konstitutive.
2. Anëtarët dhe anëtaret e Komisionit mund të vendosin që funksioni i Kryesuesit/kryesues të kufizohet në periudhë të caktuar kohore.

## Neni 32.

### *Kuorumi dhe vendimmarrja*

1. Kuorumi për punë të Komisionit ekziston kur janë prezent së paku 14 anëtarë/anëtaret të Komisionit.
2. Komisioni bënë përpjekje që të gjitha vendimet e Komisionit ti nxjerr njëzëri, por kur konsensusi është i pamundur të arrihet, së paku 14 anëtarë/e duhet të pajtohen për marrjen e vendimit.
3. Komisioni mund të vendosë që për miratimin e vendimin procedural është i mjaftueshëm pajtimi i shumicës së thjeshtë, të të gjithë anëtarëve dhe anëtareve.

## Neni 33.

### *Ndërprerja e mandatit të anëtarit/anëtares*

1. Anëtarit/anëtares të Komisionit i pushon mandati me kalimin e mandatit të Komisionit, si dhe në rastet:
  - a. Dhëni së dorëheqjes në formë të shkruar,
  - b. Vdekjes,

- c. Vendimit të plotfuqishëm gjyqësorë për kufizimin ose i privuari nga aftësia afariste,
  - d. Vendimit të plotfuqishëm gjyqësorë me dënim me burg të pakusht, dhe
  - e. Shkarkimi.
2. Në rastet e parapara në paragrafin 1, pika a, b, c, dhe d, të këtij neni, Komisioni konstaton ndërprerjen e mandatit dhe për këtë e informon kryetarin/Kryesinë e palës kontraktuese i cili/ e cila në afat prej 15 ditësh do të zgjedhë anëtarin/anëtaren e re të Komisionit nga lista të cilën e ka përcaktuar Këshilli seleksionues në procedurën e propozimit të kandidatëve për anëtarë dhe anëtaret e Komisionit.
  3. Anëtar/anëtarja e Komisionit mund të shkarkohet nga detyra në rast të mosplotësimit të obligimeve nga neni 35 dhe neni 37, si dhe në rast të dënimit me aktgjykim të plotfuqishëm për vepër penale e cila e démon integritetin dhe kredibilitetin e anëtarit/anëtares të Komisionit, si dhe në rastin e pamundësisë së vazhdueshme të kryerjes së punës zyrtare, për shkak të gjendjes së vështirë mendore, emocionale dhe fizike.
  4. Komisioni përcakton propozimin për shkarkim të anëtarit/anëtares, me përjashtim të tij/saj, dhe propozimin ia dërgon kryetarit/kryesisë së palës kontraktuese në të cilin është zgjedhur për anëtarë/anëtare të Komisionit, për të cilin propozohet shkarkimi. Para se të përcaktohet propozimi për shkarkim, Komisioni do ti mundësojë anëtarit/anëtares, për shkarkimin e të cilin vendoset, që të njoftohet me provat (faktet, të ngritura kundër tij/saj, që ti paraqes provat (faktet, në dobi të tij/saj).
  5. Në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të propozimit, Kryetari/kryesia e shtetit vendosin për shkarkim dhe për rastin e shkarkimit, dhe zgjedhë anëtarin/anëtaren e re të Komisionit nga lista të cilën Këshilli seleksionues e ka përcaktuar në procedurën e propozimin e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision.

#### Neni 34.

#### Largimi i përkohshëm nga detyra e anëtarit/anëtares së Komisionit

Nëse për anëtarin/anëtaren e Komisionit do të jetë i iniciuar hetimi kundër tij, në procedurë penale për vepër penale me të cilën cenohet kredibiliteti i tij/saj ose Komisioni kuption për rrethana tjera në raport me anëtarin/anëtaren e cila seriozisht e cenon ose mund ta cenojë integritetin dhe kredibilitetin e Komisionit, ose kur kryerja e detyrave të anëtarit/anëtares së Komisionit është vështirësuar për shkak të gjendjes së tij/saj mentale, emocionale, ose fizike, Komisioni mund të vendos që përkohësisht ta lagojë anëtarin/anëtaren në të cilin/ në të cilën kanë të bëjnë shkaqet e tillë, përderisa nuk verifikohet bazueshmëria e tyre, gjegjësisht për derisa nuk ndërpriten.

## **PJESA VIII. – TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE/ANËTAREVE DHE PERSONELIT TË KOMISIONIT**

**Neni 35.**

### *Ndërgjegjja , pavarësia dhe paanshmëria*

1. Anëtarët dhe anëtaret, të punësuarit apo personat e angazhuar në ndonjë mënyrë tjetër në Komision, janë të obliguar që të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve tjera të cilat i nxjerr Komisioni, me ndërgjegje, me paanshmëri dhe në pavarësi nga interesat e cilësdo parti tjetër politike, qeverie ose organeve tjera të pushtetit, grupeve të interesit, individëve ose të çfarëdo personi i cili drejtëdrejtë ose tërthorazi paraqet interesat e ndonjërit nga personat e përmendur, apo të personave tjere.
2. Anëtarët dhe anëtaret e Komisionit si dhe personat tjerë të punësuar në Komision nuk mund të ushtrojnë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër i cili do të mund të rrezikonte në kryerjen e detyrate në Komision ose të sjellë në dyshim pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Anëtar/ anëtarja e Komisionit dhe të punësuarit tjerë në Komision janë të obliguar që Komisionit t ia paraqesin konfliktin ekzistues, ose të mundshëm të interesit.
3. Nëse Komisioni në çfarëdo mënyre kupton që anëtarët/anëtarja e Komisionit ose i punësuari/e punësuara në Komision kanë interes personal i cili mund të sjellë deri te konflikti i interesit me rastin e kryerjes së detyrate të tij/të saja, Komisioni do të vendos për përfashtimin e personit me të cilin ka të bëj rrethana, nga procedimi i mëtejmë për atë çështje, ose do të ndërmerr masa me qëllim të shkarkimit, gjegjësisht largimit të personit të tillë nga Komisioni.
4. Nëse Komisioni nuk do të jetë i informuar me kohë për rrethanën e cila rezymon në konflikt interes i për anëtarin/anëtaren e Komisionit ose person tjetër të punësuar në Komision, dhe ai person merr pjesë në vendimmarrje ose ndërmerr veprime në çështjet që nënkuqtojnë konflikt interes, Komisioni, me tu njoftuar për një rrethanë të tillë, do të siguroj që vendimi për atë çështje përsëritet, gjegjësisht që veprimi të zbatohet përsëri pa prezencën e anëtarit/anëtares të Komisionit ose të punësuarit në Komision, që është në konflikt interes.

**Neni 36**

### *Privilegjet dhe imuniteti*

1. Me qëllim të ruajtjes së pavarësisë së Komisionit dhe veprimtarinë e saj të papenguar, anëtarët/anëtaret e Komisionit dhe të punësuarit / të punësuarat në Komision, gjatë kohës së kryerjes së funksioneve të veta gëzojnë privilegjet dhe imunitetet si vijon:
  - a. Imunitet nga paraburgosja dhe sekuestrimi i bagazhit personal;

- b. Imuniteti nga të gjitha llojet e procedurave ligjore në raport me mendimin e shprehur dhe veprimin, me mirëbesim, brenda kornizave të kryerjes së detyrave, dhe
  - c. Imuniteti nga çfarëdolloj kufizimi të lirisë së lëvizjes në raport me vajtje dhe ardhje në shtetin në të cilin kryen funksionin.
2. Imuniteti i paraparë me paragrafin 1 pika b. të këtij neni, në raport me shprehjen, e mendimit mbetet në fuqi edhe pas pushimit të detyrës si anëtarë/anëtare e Komisionit, gjegjësisht me përfundimin e angazhimit në Komision.
  3. Komisioni ka për obligim të ja ndërpres imunitetin anëtarit/anëtares dhe të punësuarit/punësuarës, nëse vërteton se imuniteti do të sjell pengesa në rrjetet juridike dhe do të rrezikojë besimin e opinionit në punën e Komisionit.

#### Neni 37.

#### *Mbrojtja e burimeve i të dhënave konfidenciale (të besueshme)*

Anëtarët dhe anëtaret e Komisionit, të gjithë të punësuarit dhe personat tjerë të angazhuar në ndonjë mënyrë tjetër nga ana e Komisionit, kanë për obligim të ruajnë konfidencën e të gjitha të dhënave për të cilat kanë njohuri gjatë kohës së kryerjes së detyrave në Komision, duke përfshirë identitetin e personit i cili ka dhënë informatat me kusht të konfidentialitetit për identitetin e tij, dhe të cilat nuk i shfrytëzojnë për qëllime personale, për aq kohë sa Komisioni nuk vendos që ato të dhëna ti publikojë në formë të njoftimit zyrtar. Ky obligim nuk ka të bëjë me faktet tanimë të njohura publikisht.

#### Neni 38.

#### *Statusi i anëtarëve/anëtareve të Komisionit dhe i personelit të Komisionit*

1. Anëtarët dhe anëtaret e Komisionit dhe të punësuarit tjerë në Komision, kryejnë detyrat me orar të plotë të punës,
2. Pagat mujore (rrogat), kompensimet dhe pagesa e shpenzimeve për anëtarët/anëtaret e Komisionit, dhe për të punësuarit të tjerë në Komision, rregullohen e Statutit, dhe janë pjesë përbërëse e buxhetit të Komisionit.

### **PJESA E IX – STRUKTURA E KOMISIONIT**

#### Neni 39

#### *Sekretariati Ekzekutiv dhe paralelet tematike*

1. Komisioni vendos zyrën qendrore në Sarajevë, me emrin Sekretariati Ekzekutiv, detyra e të cililës shtë që të ofrojë mbështetjen, teknike dhe administrative dhe operative për anëtarët e Komisionit, dhe koordinon punët mes zyrave të ndryshme dhe departamenteve tematike të cilat i vendos Komisioni.

2. Komisioni emëron dhe shkarkon Sekretarin ekzekutiv, si dhe shefat e departamenteve tematike.
3. Të punësuarit dhe personat tjerë të angazhuar në punën e Sekretariatin ekzekutiv dhe ne departamentet tematike të Komisionit, angazhohen varësisht nga shtetësia e tyre.

#### Neni 40 .

##### *Zyrat e Komisionit në palët kontraktuese*

1. Komisioni themelon zyrat në palët kontraktuese dhe, me propozim të Sekretarit ekzekutiv, emëron dhe shkarkon personat në krye të tyre.
2. Komisioni në Sarajevë, në konsultime me Sekretariatin Ekzekutiv në Sarajevë dhe në zyrën e shtetit kontraktues, mund të themelojë ekipet mobile hetuese dhe zyrat rajonale në vendet tjera në territorin e shtetit kontraktues, dhe ti emërojë dhe shkarkojë shefat e ekipeve, gjegjësisht të zyrave rajonale.
3. Në propozim të sekretarit ekzekutiv, Komisioni mund të themelon edhe ekipin hetues mobil, me autorizimin që të grumbulloj të dhëna në cilindo prej palëve kontraktuese.
4. Të punësuarit dhe personat tjerë të angazhuar më punë në Sekretariatin ekzekutiv, paralelet dhe zyrat në palët kontraktuese dhe ekipet, angazhohen pa marr parasysh nënshtetësinë e tyre.

#### Neni 41.

##### *Arkivi*

1. Sekretari ekzekutiv konstituon Njësinë për arkiv dhe bazën e të dhënave të Komisionit, si dhe e definon metodologjinë e arkivimit dhe digitalizimin e grumbullimi e të dhënave.
2. Pasi që definon metodologjinë nga paragrafi 1, dhe më së largu 6 muaj nga konstituimi, Njësia për arkiv dhe bazën e të dhënave shndërrohet në Arkiv dhe bazë e të dhënave të Komisionit, detyra e të cilës është që të arkivojë dhe digitalizojë dokumentacionin e grumbulluar (mbledhur).
3. Secila prej zyreve në shtet, është e detyruar që të themelojë njësinë për arkiv dhe bazën e të dhënave, me ngarkesë që të arkivojë dhe digitalizojë dokumentacionin të cilin e ka grumbulluar në territorin e sajë. Këto njësi, më së largu 6 muaj nga themelimi shndërrohen në arshivë dhe bazë e të dhënave në nivel të zyrës.
4. Arkivi dhe baza e të dhënave e Komisionit në Sarajevë do të jetë e unifikuar me njësitë për arkiv dhe bazën e të dhënave të zyrave në shtetet kontraktuese, më së largu 3 muaj para se të pushoj puna e Komisionit.
5. Më së paku 15 ditë para përfundimit të punës së Komisionit i dorëzon kopjet e lëndës së unifikuar arkivore dhe bazës së të dhënave, iu dorëzohen arkivate shtetërore të palëve kontraktuese dhe / ose institucioneve të cilat disponojnë kapacitetë për ruajtjen e tyre.
6. Lënda arkivore dhe baza e të dhënave të Komisionit, pas pushimit të punës së Komisionit, janë të hapura për qasje të pakufizuar ndaj të gjitha institucioneve të interesuara dhe personave, përvëç dokumentacionit i cili i nënshtrohet obligimit për ruajtjen e sekretit të të dhënave (konfidencialitetit).

## PJESA E X. – FINANCIMI I KOMISIONIT

### Neni 42.

#### *Financimi*

1. Komisioni financohet nga kontributet e palëve kontraktuese dhe donacionet.
2. Kontributet e anëtarëve paraqesin kontributin nga mjetet vjetore buxhetore të palëve kontraktuese, të cilat përcaktohen në procedurën e rregullit buxhetore përderisa zgjatë puna e Komisionit.
3. Kontributet e palëve kontraktuese sigurohen në vlera apo terme nominale, të cilat janë të cilat janë në pajtim me përqindjen e pjesëmarrjes së shteteve anëtare në vlerën e përgjithshme të caktuar, e cila është e nevojshme për funksionimin e Komisionit
4. Palët kontraktuese do të arrijnë marrëveshje për kontributet e nevojshme për punën e Komisionit.
5. Donacionet sigurohen nga burimet e ndryshme, si nga organizatat ndërkombëtare, po ashtu edhe nga personat juridik vendor.
6. Donacionet paraqesin „mjetet me të cilat udhëhiqet direkt” dhe shfrytëzohen në pajtim me marrëveshjet të cilat Komisioni do ti lidhë me organizatat ndërkombëtare dhe personat vendor juridik.
7. Llojet e kontributeve për Komisionin, duke përfshirë edhe kontributet e palëve kontraktuese, nuk mund të vlerësohen si pjesë e kontributit sipas nenit 42, paragrafi2.

### Neni 43.

#### *Raportimi financiarë*

1. Sekretari Ekzekutiv përgatit raportet vjetore për ekzekutimin e buxhetit themelor, në përputhje me rregulloret financiare të Komisionit.
2. Sekretari ekzekutiv përgatit raporte mbi shfrytëzimin e donacioneve në përputhje me rregulloret financiare të Komisionit, dhe me kërkesa të financierëve.
3. Auditori (revizori) i pavarur kryen auditivin e pavarur vjetor mbi shfrytëzimin e mjetave themelore buxhetore dhe donacioneve të cilat janë pranuar nga palët kontraktuese ose nga donatorë tjerë. Rezultatet definitive mbi auditimin, pas procesit përkatës, dhe krasas komenteve të Komisionit, Komisioni i ven në shikim të opinionit.
4. Raportet nga paragafi 1 dhe 2 të këtij neni iu nënshtronen auditimit nga ana e auditorit të pavarur.

## PJESA XI – RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT

### Neni 44.

#### *Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtarë*

1. Tre muaj para përfundimit të mandatit të vet Komisioni publikon Raportin përfundimtarë.
2. Komisioni dorëzon njëkohësisht Raportin përfundimtarë kryetarëve / kryesisë së palëve kontraktuese dhe e publikon në faqen e internetit të Komisionit, njëkohësisht e publikon (shpall) në të gjitha gjuhët zyrtare të palëve kontraktuese, dhe në gjuhën angleze.
3. Komisioni ka për obligim që njëkohësisht, apo pas dorëzimit të Raportit përfundimtarë të bëjë publik dhe të hapur rezymenë e tij.

### Neni 45

#### *Përbajtja e Raportit përfundimtarë*

1. Raporti përfundimtarë përfshinë hyrjen, faktet relevante mbi krimet e luftë she shkeljen tjera të rënda të të drejtave të njeriut, dhe në pajtim me detyrat e komisionit të parapara sipas nenit 14, të Statutit, listën e humbjeve në njerëz, listën e personave të humbur, listën e vendeve për robërim, dhe listën e torturave të përjetuara, dhe rekomandimet
2. Në mes tjerash, rekomandimet kanë të bëjnë me:
  - a. Hapat e mëtejmë të palëve kontraktuese drejtë përparimit të mirëbesimit në mes të shteteve dhe bashkësive në territorin e ish RSFJ-së;
  - b. Modelin përkatës të reparacioneve materiale dhe simbolike, mënyrën për reformimin e institucioneve si dhe mekanizmat me të cilët sigurohet integriteti i fakteve të vërtetuara në sistemet e arsimit (edukimit) të palëve kontraktuese;
  - c. Mënyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, dhe që mund të përfshijë edhe propozimin për themelimin e mekanizmit të veçantë për realizimin e qëllimit të tillë.

### Neni 46.

#### *Gjetjet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut*

1. Komisioni ka autorizim që në bazë të fakteve të vërtetuara, në Raportin përfundimtarë të konstatojë se ekziston dyshimi serioz se personi i caktuar ka kryer krim lufte, gjegjësisht shkelje të rëndë e të drejtave të njeriut. Gjetja e tillë nuk ka efekt të aktgjykimit gjyqësor, dhe as nuk e prejudikon vendimin përfundimtar të gjykatës.
2. Në reportin përfundimtar, Komisioni nuk mund të nxjerr gjetjet kundër ndonjë personi nëse nuk ka ndërmarr të gjithë hatap e arsyeshëm, që:
  - (a) Të njoftoj atë person lidhur me qëllimin e vet, për të nxjerrë gjetjet e tillë;
  - (b) Ti komunikojë personit përbajtjen e gjetjes, të dhënat në bazë të të cilave nxirret gjetja, si dhe shkaqet në të cilat është bazuar gjetja e tillë, dhe

- (c) Ti ofrojë personit mundësinë që në afat të arsyeshëm të përgjigjet në gjetjen e propozuar.
- (d) Të vërtetojë të gjeturat për personin e vdekur, në të paktën nga tri burime;
3. Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të akuzuarit, para Gjykatës ndërkontaktore ose vendore, Komisioni mundet në reportin përfundimtarë të udhëzojë në aktgjykimin përkatës. Me këtë rast Komisioni mund të vërtetojë faktet e reja.

#### Neni 47.

#### *Obligimi i Parlamentit dhe qeverisë që të shqyrtojnë Raportin përfundimtarë*

1. Pas publikimit të Raportit përfundimtar, kryetari/kryesia e çdo pale kontraktuese, reportin ia dërgon kryetarit të parlamentit. Në afat prej një muaji pas pranimit të reportit, kryetari i parlamentit thërret seancë të veçantë të parlamentit, me qëllim të shqyrimit të gjetjeve dhe rekomandimeve nga Raporti, ose e venë në rend ditë këtë temë, për mbledhjen e radhës.. Në seancë marrin pjesë një ose më shumë anëtarë të Komisionit.
2. Në afat prej 6 muajsh pas publikimit të reportit përfundimtarë të Komisionit, qeveria e çdo pale kontraktuese miraton dhe publikon në gazeten zyrtare të palës kontraktuese qëndrimin mbi zbatimin e rekomandimeve.
3. Në një afat të arsyeshëm pas përgjigjes nga qeveria sipas paragrafit 2 të këtij neni, kryetari i parlamentit në çdo palë kontraktues thërret seancën speciale të parlamentit me qëllim të shqyrimit të përgjigjes së qeverisë dhe angazhimit të mundshëm të parlamentit me qëllim të zbatimit të rekomandimit të Komisionit.

## PJESA XII – TË NDRYSHME

#### Neni 48 .

#### *Veprat penale dhe sankzionet*

1. Çdo person i cili:
  - (a) me vetëdije jep të dhëna të rreme Komisionit, apo organit apo personit i cili vepron në emër të tij;
  - (b) që me kërcënim, forcë, veprim ose premtim të përfitimeve shtyn personin tjetër për të dhënë të dhëna të rrejshme ose mos dhënien e të dhënavë Komisionit, apo organit apo personit i cili vepron në emër të tij;
  - (c) asgjëson ndonjë dokument ose mjet me qëllim të pengimit të Komisionit që të zbaton hulumtimin, ose
  - (d) të zbardhë ose në ndonjë mënyrë tjetër zbulon të dhënën të cilën e ka pranuar Komisioni me kusht konfidencialiteti, apo e tregon identitetin e personit i cili ia ka dhënë informatën, me kusht konfidencialiteti.

Konsiderohet se ka kryer vepër penale të dënueshme me dënim me burg deri në një vit, ose me dënim ekvivalent në të holla në shumën prej 5.000 euro.

2. Sanksionet nga paragrafi 1 zbatohen edhe ndaj personave zyrtarë apo privat, të cilët pa ndonjë arsyesh refuzojnë të veprojnë sipas kërkesës së Komisionit, gjegjësisht organit apo personit i cili vepron në emër të tij, për dorëzim të dokumenteve për shqyrtim, apo të burimeve tjera.
3. Në rast se personi refuzon që ti përgjigjet ftesës, ose refuzon për të dhënë deklaratë para Komisionit, zbatohen dispozitat e nenit 17, paragrafi 8 i këtij Statuti.

#### Neni 49.

##### *Roli i Komisionit në procedimin penal*

Komisioni ka autorizime që:

- (a) të propozoj, në rast se personi për të cilin Komisioni disponon me dyshime serioze se ka kryer krim lufte ose shkelje tjetër të rëndë të të drejtave të njeriut, të ia komunikojë Komisionit të dhënat me rëndësi për zbulimin e lokalitetit dhe mbetjet mortore të personave të humbur, ose për zbulimin e kryerësve të tjerë të mundshëm, dhe ajo të merret në bazë të kërkesës të akuzuarit – e jo nga ana e gjykatës – ndaj të cilët kryhet procedura penale, – si rrethanë lehtësuese me një rëndësi qenësore me rastin e shqiptimit të lartësisë së dënimit;
- (b) ti propozoj kryerësit të gjykuar për vepër penale falje të pjesërishme, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon Komisionit të dhënat e rëndësishme për zbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore për persona të humbur, ose për zbulimin e kryerësve të tjerë të mundshëm ; dhe veprave tjera;
- (c) Të propozoj zbutje të jashtëzakonshme të dënimit për kryesit të veprës penale, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të shtetit përkatës, nëse ia komunikon të dhënat e rëndësishme Komisionit për mbulimin e lokalitetit me mbetjet mortore të personave të humbur, ose për zbulimin kryerësve të tjerë të mundshëm ; dhe veprave tjera.

### PJESA XIII – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 50.

##### *Përfundimi i punës së Komisionit*

1. Pas publikimit të raportit përfundimtarë, Komisioni përfundon punën në një afat më së gjati prej tre muajsh.
2. Në atë periudhë kohore ndërmerrën masat e sistematizimit, ndarjes dhe ruajtjes së arkivit, ndarjen e pronës, përbushjes së obligimeve ndaj personave të tretë, distribuimit dhe prezantimit të raportit përfundimtarë, si dhe hartimit të raporteve financiare dhe raportimin e punës së Komisionit.

## Neni 51

### *Hyrja e Statutit në fuqi*

1. Origjinali i këtij Statuti, tekstet e të cilit janë në gjuhën shqipe, boshnjake, malazeze, kroate, sllovene, maqedone dhe serbe, vlerësohen njëloj autentike, depozitohet të organi kompetent në Bosnjë e Hercegovinë, si vendi nikoqir.
2. Shtetet kontraktuese do të njoftojnë shtetet tjera lidhur me ratifikimin.
3. Statuti hyn në fuqi ditën e parë të muajit, pas kalimit të pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e data e ratifikimit të fundit.